

**AKT THEMELIMI**  
**DHE**  
**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ACC" SHPK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, sot më datë 18.04.2024, themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emër subjekti “ACC” SHPK dhe emër tregtar All Comms Consulting (këtu e më poshtë “Shoqëria”), veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

**Neni 1**

**Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e këtij Statuti si dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi:

- Ligji Nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar.

**Neni 2**

**Ortakët e shoqërisë**

Kjo Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themelohet nga ortakët:

- **Endri Fuga**, lindur në Tiranë, më 11.11.1981, i identifikuar me letërnjoftimin me nr. 033587051 dhe Nr. Personal I11111270P.

### **Neni 3**

#### **Forma ligjore**

Shoqëria ka formën e “shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar” ose “SHPK”. Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

### **Neni 5**

#### **Selia**

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Seit Teqja 03950073, No. 92, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në cilësinë e ortakut ose aksionerit në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

### **Neni 6**

#### **Dokumentet e Shoqërisë**

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
  - a) *numrin unik të identifikimit;*
  - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
  - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
  - ç) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
  - d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

## Neni 7

### Objekti i veprimtarisë

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:  
*Konsulenca në fushën e komunikimit, marrëdhënieve publike, marketingut, strategjisë dhe interpretimi i gjetjeve të sondazheve të opinionit publik. Konceptimi, ideimi, organizimi dhe zbatimi i konferencave, eventeve, projekteve, programeve dhe fushatave të ndryshme të përshtatura me nevojat specifike të klientëve.*
- 7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

## Neni 8

### Kapitali themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të përbëhet nga kontributi themeltar i Ortakëve Themelues të kësaj Shoqërie në para, në vlerën **100 (njëqind) lekë**.
- 8.2 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë, dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, i ndarë në këto raporte:

#### **Ortaku Themelues:**

**Endri Fuga, zotërues i 1 (një) kuote, pjesëmarrës në masën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë.**

## Neni 9

### Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve nëse Asambleja e Ortakëve do të marrë vendim për shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një ose më shumë së dy ortakë. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

## Neni 10

### **Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të Administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit, duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

## **Neni 11**

### **Asambleja e ortakëve**

- 11.1 Asambleja e ortakëve përbëhet nga Ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga Administratori/ët e shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore dhe miraton sa më poshtë vijon:
- *ndryshimi i dispozitave të statutit;*
  - *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitali;;*
  - *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël;*
  - *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël;*
  - *miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
  - *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë apo riorganizimin e saj;*
  - *miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;*
  - *mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme e shoqërisë;*
  - *çështje të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi si dhe nga dispozitat e këtij Statuti në mënyrë të shprehur.*
- 11.3 Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj.
- 11.4 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b)shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç)vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

- 11.5 Mbledhja e Asamblesë së ortakëve thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund t'i dërgohet ortakëve edhe nëpërmjet postës elektronike në adresat e e-mailit të përcaktuar prej tyre, por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.6 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të përgjithshme apo të posaçme të lëshuar paraprakisht, prej tyre.
- 11.7 Mbledhja e Asamblesë mund të realizohet edhe në distancë si dhe në një vend apo shtet tjetër të ndryshëm nga vendndodhja e selisë së shoqërisë. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen/t e asamblesë me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike vizuale, videokonferencë etj, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

*a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;*

*b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;*

*c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.*

Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në Mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

- 11.8 Nëse lind nevoja, me propozim të Administratorit, mbledhjet e Asamblesë së ortakëve mund të zhvillohen në praninë e një Noteri, i cili garanton identifikimin e ortakëve, procesin e votimit dhe vendimarrjen.

## Neni 12

### Vendimmarrja

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e ortakëve, vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, Asambleja e ortakëve, vendos me 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së ortakëve. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari/Administratori/ët dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit). Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së ortakëve.

## Neni 13

### Administratori

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i shoqërisë është:
  - **Endri Fuga**, lindur në Tiranë, më 11.11.1981, i identifikuar me letërnjoftimin me nr. 033587051 dhe Nr. Personal I11111270P.

Administratori përfaqëson dhe administron shoqërinë tregtare.

Administratori ka të të gjitha të drejtat dhe tagrat në përfaqësimin dhe administrimin e shoqërisë, që ky statut dhe ligji i njeh.

Statut  
"All Comms Consulting" Shpk

Administratori është i autorizuar të kryejnë/delegojnë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme, me qëllim regjistrimin e Shoqërisë "ACC" SHPK, për fillimin e veprimtarisë sipas objektit të përcaktuar në këtë Statut të nënshkruar nga ortaktët.

- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë të drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë, të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e Shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të Shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.
- 13.4 Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim brenda kompetencave të tij ose të dhëna me Vendim të Asamblesë së Ortakëve si dhe të krijojë, të ndryshojë apo të dalë nga marrëdhënie juridike me palë të treta.
- 13.5 Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij për realizimin e veprimeve të caktuara ose kategori veprimesh tek persona të tretë të punësuar ose jo në shoqërinë tregtare, nëpërmjet një Prokure të posaçme.

Të gjitha veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi me Prokurë, në ushtrim të objektit të veprimtarisë së Administratorit, konsiderohen të vlefshme dhe njësor si të ishin kryer prej vetë Administratorit.

Veprimet e kryera nga përfaqësuesi me Prokurë janë të detyrueshme për Shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, kur këto veprime miratohen nga Administratori dhe Ortakët e Shoqërisë, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve.

#### **Neni 14**

##### **Kontrolli financiar**

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

#### **Neni 15**

##### **Viti financiar**

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

### **Neni 16**

#### **Bilanci dhe Dividendët**

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor Administratori merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

### **Neni 17**

#### **Likuidimi dhe prishja**

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

### **Neni 18**

#### **Dispozita mbyllëse**

- Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Ky Statut përpilohet në 4 (kater) kopje orgjinale në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

*\*Administratori i parë është i autorizuar të kryejë/delegojë të gjitha veprimet proceduriale të nevojshme, me qëllim regjistrimin e shoqërisë "ACC" SHPK pranë QKB-së dhe instiucioneve të tjera, për fillimin e veprimtarisë sipas objektit të përcaktuar në këtë Statut të nënshkruar nga Ortaktët.*



Statut  
"All Comms Consulting" Shpk

**ORTAKËT THEMELUES**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ALL COMMS CONSULTING" SHPK**

**ENDRI FUGA**

ENDRI FUGA



**TIRANË, më 18.04.2024**